



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 276 Akti**

**Nr. 181 Vendimi**

**Tiranë, më 18.7.2019**

**V E N D I M**

Trupit gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Valbona Sanxhaktari</b>	Kryesuese
<b>Xhensila Pine</b>	Anëtare
<b>Etleda Çiftja</b>	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot, në datën 16 korrik 2019, ora 11:00, në Pallatin e Koncerteve, kati i I-rë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Elida Kaçkini, prokurore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.**

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

## KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, znj. Elida Kaçkini, vëzhguesin ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot, dhe pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, e cila në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin e saj në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

#### I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Znj. Elida Kaçkini është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të saj si prokurore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, ‘Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”, dhe në ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

2. Znj. Elida Kaçkini bazuar në nenin 14, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.3.2019 me trupin gjykues të përbërë nga komisioneret:

Valbona Sanxhaktari

Xhensila Pine

Etleda Çiftja

3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI) sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) sipas neneve 34 - 39, të ligjit nr. 84/2016; dhe nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP) sipas neneve 40 - 44, të ligjit nr. 84/2016.

4. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin nr. 1, datë 24.1.2019, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit; të caktojë kryesuese të trupit gjykues komisioneren Valbona Sanxhaktari. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Trupi gjykues, me vendimin nr. 2, në datën 1.7.2019, vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit, znj. Elida Kaçkini, bazuar në relativimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 i interpretuar bashkë me nenet D dhe DH dhe E, të Aneksit të Kushtetutës; (iii) të njoftojë subjektin e

rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarin e konfliktit të interesit, me të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

6. Në datën 1.7.2019, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën, brenda datës 10.7.2019; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative, duke paraqitur kërkesë për njohjen me dosjen brenda pesë ditëve nga marrja e njoftimit me *e-mail*; si dhe (iv) përbërjen e trupit gjykues.

7. Në datën 11.7.2019, me vendimin nr. 3, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Elida Kaçkini, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016. Përmes postës elektronike subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 16.7.2019, ora 11:00, në Pallatin e Koncerteve, kati i I-rë, Tiranë.

8. Bazuar në pikën 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Elida Kaçkini, bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

9. Në datën 16.7.2019 u zhvillua seanca dëgjimore në prezencë të subjektit të rivlerësimit dhe në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot, në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht në seancë.

10. Seanca dëgjimore e datës 16.7.2019, u ndërpre, për të rifilluar në datën 18.7.2019, për shpalljen e vendimit. Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

## **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

11. Subjekti i rivlerësimit, znj. Elida Kaçkini, ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit në përputhje me nenin 48, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

## **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

12. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

Sipas kreut IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë":

- i. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror.
- ii. DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjekti të rivlerësimit.
- iii. Prokuroria e Përgjithshme është organi përkatës i vlerësimit profesional i cili, në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjorë të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe pesë dokumenteve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

13. Referuar vendimit nr. 2/2017<sup>1</sup> të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet, dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

## V. RIVLERËSIMI I PASURISË

### V/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

14. ILDKPKI-ja, me shkresën nr. \*\*\*, datë 3.4.2018, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Elida Kaçkini, e cila është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2006, me nr. indeksi \*\*\* dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

15. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private nga viti 2006 deri në vitin 2016 dhe, në datën 25.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar “Deklaratën e Pasurisë së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personave të lidhur, është konstatuar:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

<sup>1</sup> Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

## **V/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

16. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”, të vitit 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI nga viti 2003 deri në 2016; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (e) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (ç) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit në datën 10.7.2019, e në vijim, deri ditën e seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

17. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) në verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; dhe (iv) në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016.

### **Personat e lidhur, apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit që janë hetuar**

18. Për efekt të procesit të rivlerësimit, personat që janë hetuar si të lidhur, apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, janë si më poshtë vijon:

18.1 B.K. – bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, konsiderohet person i lidhur.

18.2 B.K. (vjehtëri) – për shkak të huadhënies së shumës 12.000 euro personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit.

18.3 E.D. – për shkak të huadhënies së shumës 12.000 euro personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit.

### **V/3 Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting” të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur:**

#### **1. Automjet tip "Opel Corsa", me targa \*\*\*.**

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit, administroi:

1.1 Deklaratën “Vetting” të viti 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur<sup>2</sup>.

1.2 Dokumentacionin e administruar nga ILDKPKI-ja dhe Komisioni.

1.3 Provat shkresore dhe deklaratat e administruara nga Komisioni.

---

<sup>2</sup> Kontratë shitje automjeti nr. \*\*\*, datë 19.2.2007, deklaratë doganore për pagesën e detyrimit, në vlerën 900 euro, kontratë kredie bankare, datë 12.2.2007, në “Raiffeisen Bank”.

b. Arsytimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm

1.4 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se disponon një automjet tip "Opel Corsa", me targa \*\*\*, viti i prodhimit 1998, sipas kontratës noteriale nr. \*\*\*, datë 19.2.2007, me vlerë 250.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

1.5 Si burim krijimi, subjekti ka deklaruar kredi në shumën 400.000 lekë, në datën 12.2.2007, në “Raiffeisen Bank”, me afat 24 muaj, shlyer plotësisht.

1.6 Nga hetimi administrativ kryesisht u konstatua se sipas kontratës së kredisë në “Raiffeisen Bank”<sup>3</sup>, datë 12.2.2007, konfirmohet marrja e kredisë nga subjekti i rivlerësimit me afat 24 muaj. Kontrata e kredisë është mbyllur në datën 16.2.2009. Qëllimi i dhënies së kredisë është “përdorimi për arsye personale”. Kredia është *disbursuar* në datën 16.2.2007, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit ka kryer një tërheqje me vlerë 470.000 lekë në datën 19.2.2007.

1.7 Në deklaratën periodike vjetore të viti 2017, subjekti deklaron shitjen e këtij automjeti për skrap pranë personit fizik Sh.D., me NIPT \*\*\*, me seli në Kashar, sipas procesverbalit të datës 23.12.2017, në vlerën 25.000 lekë. Nga hetimi i Komisionit<sup>4</sup> rezulton se ky automjet është hequr nga qarkullimi përfundimisht në datën 26.12.2017, sipas kërkesës së subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 102, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë.”, dhe në nenin 9, të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, “Përrjashtimi nga pagimi i taksave kombëtare”, i ndryshuar.

1.8 Gjatë hetimit, në pyetësin e datës 28.3.2019, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka jetuar me prindërit dhe familjarë të tjerë deri në nëntor të vitit 2012. Komisioni, në pyetësin e datës 3.6.2019, i kërkoi subjektit që të paraqesë dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e prindërve dhe familjarëve të tjerë, të realizuara përgjatë periudhës 2004 – nëntor 2012, me qëllim përcaktimin e shpenzimeve jetike. Në përgjigjen e saj në datën 11.6.2019, subjekti i rivlerësimit paraqiti dokumentacion ligjor justifikues në lidhje me të ardhurat e

---

<sup>3</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 26.3.2019, e “Raiffeisen Bank”.

<sup>4</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 10.6.2019, e DPSHTRR-së.

shtetasve H.C. (i ati)<sup>5</sup>, S.C. (e ëma)<sup>6</sup>, A.C. (i vëllai)<sup>7</sup>, E.C. (e kunata)<sup>8</sup> dhe L.C. (e motra)<sup>9</sup>. Për periudhën 2004– 2012, të ardhurat e familjarëve paraqiten në tabelën e mëposhtme:

**Tabela nr. 1**

Viti / Emër mbiemër	H. C.	S. C.	A. C.	E.C. (kunata)	L. C.	Totali për çdo vit
<b>2004</b>	457,464	164,720	934,276		137,305	<b>1,693,765</b>
<b>2005</b>	457,464	166,247	808,559		217,726	<b>1,649,996</b>
<b>2006</b>	466,308	168,968	1,297,298		270,602	<b>2,203,176</b>
<b>2007</b>	466,686	182,208	810,282		310,734	<b>1,769,910</b>
<b>2008</b>	486,462	201,516	1,076,540		472,064	<b>2,236,582</b>
<b>2009</b>	525,004	217,216	1,911,806		590,697	<b>3,244,723</b>
<b>2010</b>	570,394	226,896	1,958,854		510,000	<b>3,266,144</b>
<b>2011</b>	381,694	137,657	2,036,201	310,710	503,321	<b>3,369,583</b>
<b>2012</b>	286,270	30,825	2,131,043	354,600	850,753	<b>3,653,491</b>

1.9 Komisionit, nga hetimi administrativ, bazuar në faktet e sipërpërmendura, i rezultoi se personat me të cilët ka bashkëjetuar subjekti i rivlerësimit për periudhën 2006 – 2012, kanë pasur të ardhura te ligjshme të mjaftueshme për përballimin e jetesës.

1.10 Meqenëse, gjatë periudhës së bashkëjetesës me prindërit, subjekti i rivlerësimit nuk ka krijuar pasuri të tjera përveç automjetit të blerë me kredi, në analizën financiare për periudhën përpara martesës (2004 – 2011), janë marrë në konsideratë të ardhura, pasuri dhe shpenzime vetëm të subjektit të rivlerësimit. Sipas vërtetimeve të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, konstatohet se të ardhurat nga paga janë në shumën 2.551.236 lekë.

<sup>5</sup> Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare lëshuar nga: Reparti Ushtarak nr. \*\*\* Burrel, për periudhën 1.1.2002 – 1.7.2003; Reparti Ushtarak nr. \*\*\* (Zallherr) Tiranë, për periudhën 2003 – datë 1.10.2006; Komanda e Forcës së Bashkuar Durrës nga 1.10.2006 – 21.12.2009; Komanda e Forcës së Bashkuar Durrës nga 1.1.2010 – 28.02.2010; Komanda e Forcës Tokësore (R.U nr. \*\*\*) nga 1.3.2010 – 30.6.2011; vërtetim për trajtim me pagesë kalimtare të ushtarakut në rezervë nga 1.9.2011 – 1.7.2013.

<sup>6</sup> Katër vërtetime për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare lëshuar nga: Bashkia Burrel për periudhën 1.1.1994 – 15.9.2003; Reparti Ushtarak nr. \*\*\* për periudhën 1.9.2003 – 30.9.2006; Komanda e Forcës së Bashkuar për periudhën 1.10.2006 – 31.12.2009; Komanda e Forcës së Bashkuar për periudhën 1.1.2010 – 28.2.2010; Komanda e Forcës Tokësore për periudhën 1.3.2010 – 14.5.2011; Shërbimi kombëtar i punësimit për periudhën 15.5.2011 – 14.5.2012.

<sup>7</sup> Vërtetim i shoqërisë tregtare “\*\*\*” sh.a., datë 3.11.2016 për të dhënat e punësimit dhe të ardhurat për periudhën 15.1.2001 – 11.12.2006, vërtetim i Institutit të Sigurisë “\*\*\*”, datë 25.10.2016 për të dhënat e punësimit për periudhën 1.8.2003 – 16.3.2004; vërtetim i Postës Shqiptare sh.a, datë 28.10.2016, për periudhën e punësimit gusht 2006 – shtator 2007; vërtetim i drejtorisë së përgjithshme të “Raiffeisen Bank” sh.a., datë 20.10.2016, për periudhën e punësimit 17.9.2007 – 3.3.2009, vërtetim i shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., datë 11.11.2016, për periudhën e punësimit nga 10.2.2009 e në vazhdim, deri datën që është lëshuar vërtetimi.

<sup>8</sup> Vërtetim i shoqërisë “\*\*\*”, datë 24.10.2016, për periudhën e punësimit 1.7.2011 deri në datën e lëshimit të vërtetimit.

<sup>9</sup> Vërtetim për pagën lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për periudhën mars 2004 – tetor 2005, vërtetim për pagën lëshuar nga Gjykata e Krimeve të Rënda për periudhën shtator 2005 – maj 2008; vërtetim lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të pasurive të paluajtshme për periudhën maj 2008 – tetor 2009; vërtetim lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës për periudhën 2009 – 2011 dhe shpërbllim për botim shkencor për vitin 2012; vërtetim lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për periudhën 2011 – 2014.

1.11 Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, në lidhje me mundësitë financiare të shlyerjes së kredisë së marrë përgjatë periudhës 2007 – 2008 – 2009, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar blerjen e këtij automjeti, sipas tabelës më poshtë:

**Tabela nr. 2**

	Përshkrimi	Viti 2007	Viti 2008	Viti 2009	Total 2007-2009
<b>1</b>	<b>PASURI</b>	<b>250,000</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>250,000</b>
	Automjet "Opel Corsa", targa ***, datë 19.2.2007	250,000			250,000
<b>2</b>	<b>DETYRIME</b>	<b>400,000</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>400,000</b>
	Kredi bankare "Raiffeisen Bank", datë 12.2.2007	400,000			400,000
<b>3</b>	<b>TË ARDHURA</b>	<b>833,086</b>	<b>876,473</b>	<b>841,677</b>	<b>2,551,236</b>
	Të ardhura nga pagat, subjekti	833,086	876,473	841,677	2,551,236
<b>4</b>	<b>SHPENZIME</b>	<b>658,812</b>	<b>826,655</b>	<b>659,387</b>	<b>2,144,853</b>
	Shpenzime për shlyerjen e kredisë "Raiffeisen Bank"	207,696	239,636	42,939	490,271
	Shpenzime jetese sipas anketës së buxhetit të familjes	315,696	376,764	376,764	1,069,224
	Shpenzime për udhëtime nga sistemi <i>TIMS</i>	135,419	118,255	131,683	385,358
	Shpenzime transferimi vendbanim - vendi i punës	0	92,000	108,000	200,000
<b>5</b>	<b>LIKUIDITETE NË FILLIM TË PERIUdhËS</b>	<b>66,302</b>	<b>780</b>	<b>199</b>	<b>67,281</b>
	Gjendja e llogarive bankare	66,302	780	199	67,281
	Gjendje <i>CASH</i>	0	0	0	0
<b>6</b>	<b>LIKUIDITETE NË FUND TË PERIUdhËS</b>	<b>780</b>	<b>199</b>	<b>159,706</b>	<b>160,685</b>
	Gjendja e llogarive bankare	780	199	-40,294	-39,315
	Gjendje <i>CASH</i>	0	0	200,000	200,000
	<b>DIFERENCA (TË ARDHURA -PASURI-SHPENZIME 3+2-1-4+5-6)</b>	<b>389,796</b>	<b>50,399</b>	<b>22,784</b>	<b>462,979</b>

1.12 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe ato të administruara gjatë hetimit, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka burime financiare me dokumentacion justifikues ligjor, në lidhje me këtë aset.

## **2. Automjet tip "Volswagen 3B Passat", me targa \*\*\***

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit, administroi:

2.1 Deklaratën "Vetting" të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëngjitur.<sup>10</sup>

<sup>10</sup> Vërtetim page datë 20.1.2017, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; vërtetim page datë 10.10.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje; të ardhura nga puna: pozicioni, asistent-koordinatror pranë Qendrës Shqiptare të të Drejtave të Njeriut; gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë; gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; pedagog pranë Universitetit "Gjon Buzuku" Shkodër (shoqëria "\*\*\*\*" sh.p.k.)



2.2 Provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja dhe Komisioni.

2.3 Dokumentacionin e administruar nga DRSHTRR-ja.

b. Arsytimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm

2.4 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se disponon automjet me targa \*\*\*, tip "Volswagen 3B Passat", viti i prodhimit 2002, sipas kontratës noteriale nr. \*\*\*, datë 14.8.2014, me vlerë 500.000 lekë. Pjesa takuese: 50% me bashkëshortin.

2.5 Si burim krijimi subjekti deklaroi se kanë shërbyer kursimet nga paga e dy bashkëshortëve (duke mos përcaktuar periudhë).

2.6 Nga hetimi administrativ kryesisht u konstatua se sipas vërtetimeve të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, të ardhurat nga paga për periudhën 1.1.2014 – 14.8.2014 janë në shumën 701.188 lekë.

2.7 Subjekti i rivlerësimit, në pyetësozin e datës 28.3.2019, ka deklaruar se bashkëjetesa me bashkëshortin e saj ka filluar pas lidhjes së martesës në datën 30.11.2012.

2.8 Sipas vërtetimeve të pagës së bashkëshortit, të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit dhe të administruara nga Komisioni<sup>11</sup>, konstatohet se të ardhurat nga paga si gjyqtar për periudhën 1.1.2014 – 14.8.2014, janë në shumën 671.863 lekë.

2.9 Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar blerjen e këtij automjeti, të pasqyruara në tabelën e mëposhtme:

**Tabela nr. 3**

	<b>Përshkrimi</b>	<b>01.01.2014-14.08.2014</b>
<b>1</b>	<b>PASURI</b>	<b>500,000</b>
	Automjet marka "Volswagen 3B Passat", me targa ***, datë 14.8.2014	500,000
<b>2</b>	<b>TË ARDHURA</b>	<b>1,373,051</b>
	Të ardhura nga pagat, subjekti	701,188
	Të ardhura nga pagat bashkëshorti si gjyqtar	671,863
<b>3</b>	<b>SHPENZIME</b>	<b>632,110</b>
	Shpenzime jetese sipas anketës së buxhetit të familjes	393,923
	Shpenzime për udhëtime nga sistemi <i>TIMS</i>	238,187
<b>4</b>	<b>LIKUIDITETE NË FILLIM TË PERIUDHËS</b>	<b>460,478</b>
	Gjendja e llogarive bankare	460,478
	Gjendje <i>cash</i>	0
<b>5</b>	<b>LIKUIDITETE NË FUND TË PERIUDHËS</b>	<b>491,183</b>

<sup>11</sup> Vërtetim nr. \*\*\*, datë 7.6.2019, të ardhura nga paga pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, shkresa nr. \*\*\* prot., datë 3.6.2019, drejtuar Universitetit “Gjon Buzuku” Shkodër është kthyer mbrapsht nga posta, pasi marrësi figuron i larguar.

Gjendja e llogarive bankare	491,183
Gjendje <i>cash</i>	0
<b>DIFERENCA (TË ARDHURA -PASURI-SHPENZIME 2-1-3+4-5)</b>	<b>210,236</b>

2.10 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e administruara gjatë hetimit, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka burime financiare me dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e deklaruara.

### 3. Depozitë bankare 12-mujore "Credins".

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit, administroi:

3.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur.<sup>12</sup>

3.2 Provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja dhe Komisioni.

3.3 Dokumentacionin e administruar nga “Credins Bank”<sup>13</sup>.

b. Arsytimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm

3.4 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi se disponon një depozitë bankare, me nr. \*\*\*, me vlerë 313.151 lekë, çelur në datën 5.5.2014, në “Bankën Credins” Pjesa takuese: 100 %.

3.5 Si burim krijimi subjekti deklaroi se kanë shërbyer kursimet nga paga.

3.6 Nga hetimi administrativ kryesisht u konstatua se subjekti disponon depozitë 12-mujore në vlerën 313.151 lekë. Kjo depozitë bankare është krijuar nga dy transfertat në datën 5.5.2014: (1) transfertë në shumën 260.000 lekë nga llogaria e depozitës “Plus” te llogaria e depozitës 12 mujore; dhe (2) transfertë në shumën 40.000 lekë nga llogaria e pagës te llogaria e depozitës 12 mujore të subjektit të rivlerësimit. Ndërkohë diferenca prej 13.151 lekësh përbëhet nga interesat bankare të depozitës.

3.7 Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti, kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar këtë depozitë, të pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

**Tabela nr. 4**

	<b>Përshkrimi</b>	<b>Viti 2014</b>
<b>1</b>	<b>PASURI</b>	<b>500,000</b>
	Automjet, tip “Volkswagen 3B Passat”, targa ***, datë 14.8.2014	500,000
<b>2</b>	<b>TË ARDHURA</b>	<b>2,165,480</b>
	Të ardhura nga pagat subjekti	1,098,535

<sup>12</sup> Kontratë depozite, datë 11.2.2013 midis Elida Celami dhe “Credins Bank”; nxjerrje llogarie, datë 19.1.2017, në “Credins Bank”, në emër të Elida Kaçkini, me gjendje në vlerën 313,151 lekë; vërtetim page datë 20.1.2017, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; vërtetim page datë 10.10.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

<sup>13</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 20.2.2019.

	Të ardhura nga pagat bashkëshorti i subjektit si gjyqtar	1,032,792
	Të ardhura nga pagat bashkëshorti si pedagog Gj. Buzuku + lehtësues në Shkollën e Magjistraturës	34,153
	<b>SHPENZIME</b>	<b>868,463</b>
<b>3</b>	Shpenzime jetese sipas anketës së buxhetit të familjes	630,276
	Shpenzime për udhëtime nga sistemi <i>TIMS</i>	238,187
	<b>SHTESA / PAKËSIM TË LIKUIDITETEVE</b>	<b>310,473</b>
	Shtesë/pakësim llogari rrjedhëse lekë Credins subjekti nr ***	46,972
<b>4</b>	Shtesë/pakësim Depozitë në lekë PLUS Credins subjekti nr ***	-38,627
	Shtesë/pakësim Depozitë në lekë 12M Credins subjekti nr ***	300,000
	Shtesë/pakësim Llogari rrjedhëse në euro Raiffeisen subjekti nr ***	0
	Shtesë/pakësim Llogari rrjedhëse Tirana Bank bashkëshorti i subjektit nr ***	-194,471
	Shtesë/pakësim Llogari rrjedhëse në lekë BKT bashkëshorti i subjektit nr ***	196,599
	Shtesë/pakësim CASH	0
	<b>DIFERENCA (TË ARDHURA -PASURI-SHPENZIME 2-1-3-4</b>	<b>486,544</b>

3.8 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e administruara gjatë hetimit, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin si dhe ka burime financiare me dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e deklaruara.

#### 4. Depozitë Plus “Banka Credins”

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit, administroi:

4.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur.<sup>14</sup>

4.2 Provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja dhe Komisioni.

4.3 Dokumentacionin e administruar nga “Credins Bank”.<sup>15</sup>

b. Arsytimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm

4.4 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi se disponon një depozitë plus në "Credins Bank", me nr. \*\*\*, datë 11.2.2013, rinovuar në datë 5.5.2014, vlera 266.001 lekë. Pjesa takuese: 100%.

4.5 Si burim krijimi deklarohen kursimet nga paga.

4.6 Nga hetimi administrativ kryesisht u konstatua se subjekti i rivlerësimit disponon depozitë bankare në vlerën 266.001 lekë në datën 19.01.2017. Kjo depozitë bankare është krijuar me një depozitim fillestar në shumën 50.000 lekë nga subjekti i rivlerësimit në datë 11.2.2013 në llogarinë e pagës, shumë e cila është transferuar në të njëjtën datë në llogarinë e depozitës. Më pas, vlera e depozitës është shtuar me transfertat periodike nga llogaria e pagës te llogaria e depozitës, duke nisur me 15.000 lekë në muaj përgjatë periudhës mars 2013 – prill 2014 dhe

<sup>14</sup> Nxjerrje llogarie me gjendje në vlerën 266,001 lekë, datë 19.1.2017, në “Credins Bank”, në emër të Elida Kaçkini.

<sup>15</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 20.2.2019.

duke vazhduar me 20.000 lekë nga muaji maj 2014 deri në fund të periudhës së hetuar nga Komisioni.

4.7 Sipas vërtetimeve të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, konstatohet se të ardhurat nga paga për periudhën 2013 – 2016 janë në shumën 4.160.709 lekë.

4.8 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se bashkëjetesa me bashkëshortin e saj ka filluar pas lidhjes së martesës. Sipas vërtetimeve të pagës së bashkëshortit, të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit dhe të marra nga Komisioni, konstatohet se të ardhurat nga paga si gjyqtar për periudhën 2013 – 2016 janë në shumën 4.082.447 lekë; të ardhurat si lehtësues në Shkollën e Magjistraturës janë në shumën 29.490 lekë dhe të ardhura si pedagog në Universitetin "Gjon Buzuku" Shkodër, përgjatë periudhës 2013 – 2014 janë në shumën 140.263 lekë

4.9 Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, përgjatë periudhës së krijimit të këtyre likuiditeteve, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti, kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar këtë gjendje depozitë.

4.10 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e administruara gjatë hetimit, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka burime financiare me dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e deklaruara.

## **5. Llogari rrjedhëse në “Credins Bank”**

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit, administroi:

5.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur.<sup>16</sup>

5.2 Provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja dhe Komisioni.

5.3 Dokumentacionin e administruar nga “Credins Bank”.<sup>17</sup>

b. Arsytimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm

5.4 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi se disponon gjendje në llogari rrjedhëse, me nr. \*\*\*, në vlerën 185.222 lekë, në “Credins Bank”. Pjesa takuese: 100 %.

5.5 Si burim krijimi deklarohet se kanë shërbyer kursimet nga paga.

5.6 Nga hetimi administrativ kryesisht u konstatua se subjekt i rivlerësimit disponon llogari rrjedhëse me gjendje në vlerën 185.222 lekë, në datë 19.01.2017, e akumuluar duke filluar nga viti 2013 e në vazhdim. Kreditimet në këtë llogari vijnë nga paga dhe të tjera (si depozitime apo rimbursime).

5.7 Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni rezultoi se përgjatë periudhës së krijimit të këtyre likuiditeteve, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti, kanë pasur të ardhura të ligjshme, të mjaftueshme, për të krijuar këtë gjendje llogarie bankare, të pasqyruar në tabelën më poshtë:

---

<sup>16</sup> Nxjerrje llogarie me gjendje në vlerën 185,222 lekë, datë 19.1.2017, në “Credins Bank”, në emër të Elida Kaçkini; vërtetim page datë 20.1.2017, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>17</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 20.2.2019.

**Tabela nr. 5**

	Përshkrimi	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Total 2013 - 2016
<b>1</b>	<b>PASURI</b>	<b>0</b>	<b>500,000</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>500,000</b>
	Automjet "Volswagen 3B Passat", targa ***, datë 14.8.2014	0	500,000	0	0	500,000
<b>2</b>	<b>TË ARDHURA</b>	<b>1,885,235</b>	<b>2,165,480</b>	<b>2,180,188</b>	<b>2,195,157</b>	<b>8,426,060</b>
	Të ardhura nga pagat subjekti	856,459	1,098,535	1,104,225	1,101,490	4,160,709
	Të ardhura nga pagat bashkëshorti si gjyqtar	922,666	1,032,792	1,053,568	1,073,421	4,082,447
	Të ardhura nga pagat bashkëshorti si pedagog Universiteti "Gjon Buzuku" + lehtësues Shkolla e Magjistraturës	106,110	34,153	14,745	14,745	169,753
	Të ardhura nga interesat e depozitës në "Credins Bank"	0	0	7,650	5,501	13,151
<b>3</b>	<b>SHPENZIME</b>	<b>1,031,728</b>	<b>868,463</b>	<b>996,772</b>	<b>1,633,915</b>	<b>4,530,877</b>
	Shpenzime jetese sipas anketës së buxhetit të familjes	630,276	630,276	692,160	661,752	2,614,464
	Shpenzime për arredim të shtëpisë (***)	100,000	0	9,490	0	109,490
	Shpenzime për udhëtime nga sistemi TIMS	21,032	238,187	295,122	272,163	826,503
	Shpenzime mjekësore subjekti (Spitali ***)	0	0	0	700,000	700,000
	Shlyerje detyrimi E.D.	280,420	0	0	0	280,420
<b>4</b>	<b>SHTESA / PAKËSIMET TË LIKUIDITETEVE</b>	<b>403,850</b>	<b>310,473</b>	<b>759,346</b>	<b>239,921</b>	<b>1,713,591</b>
	Shtesë/pakësim llogari rrjedhëse lekë "Credins Bank" subjekti nr. ***	32,342	46,972	49,758	17,634	146,706
	Shtesë/pakësim depozitë në lekë PLUS "Credins Bank" subjekti	201,949	-38,627	241,425	-158,745	246,002
	Shtesë/pakësim depozitë në lekë 12M "Credins Bank" subjekti	0	300,000	7,650	5,501	313,151
	Shtesë/pakësim llogari rrjedhëse në euro "Raiffeisen Bank" subjekti	-1,180	0	0	0	-1,180
	Shtesë/pakësim llogari rrjedhëse "Tirana Bank" bashkëshorti i subjektit	144,267	-194,471	-5,336	-888	-56,428
	Shtesë/pakësim llogari rrjedhëse në lekë "BKT" bashkëshorti i subjektit	26,473	196,599	465,849	376,419	1,065,339
	Shtesë/pakësim <i>cash</i>	0	0	0	0	0
	<b>DIFERENCA (TË ARDHURA -PASURI-SHPENZIME 2-1-3-4)</b>	<b>449,657</b>	<b>486,544</b>	<b>424,071</b>	<b>321,320</b>	<b>1,681,592</b>

5.8 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e administruara gjatë hetimit, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka burime financiare me dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e deklaruara.

**6. Apartament banimi, me sip. 78.33 m<sup>2</sup>, Yzberisht, Komuna Kashar, deklaruar nga personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit**

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit, administroi:

6.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur.<sup>18</sup>

6.2 Provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja dhe Komisioni.

6.3 Dokumentacionin e administruar nga ZVRPP Tiranë.<sup>19</sup>

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm

6.4 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit deklaroi se disponon pasuri veçmas në emrin e tij, një apartament banimi, me sip. 78.33 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z.k. \*\*, Yzberisht, Komuna Kashar, Qarku Tiranë, blerë me kontratën e shitblerjes nr. \*\*, datë 30.11.2011, midis shitësit, shoqërisë “\*\*\*” dhe blerësit B.K., në zbatim të kontratës së porosisë nr. \*\*, datë 5.1.2010, vlera 32.260 euro. Pjesa takuese: 100 %.

6.5 Si burim krijimi personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit deklaroi kursimet nga paga të tij dhe huamarrje nga huadhënësit E.D. dhe B.K. në vitin 2010.

6.6 Personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit për vërtetimin e deklaratimeve të tij ka paraqitur dokumentacion ligjor provues, bashkëlidhur deklaratës “Vetting”<sup>20</sup>.

6.7 Nga hetimi administrativ Komisioni konstatoi se ky apartament është porositur me anë të kontratës së porosisë nënshkruar midis personit të lidhur, z. B.K., dhe shoqërisë “\*\*\*”, në datën 5.1.2010, për një vlerë **38,260 euro**. Sipas nenit 2 të kësaj kontrate, personi i lidhur, z. B.K., shumë prej 38.260 euro e ka paguar në llogarinë e sipërmarrësit në momentin e lidhjes së kësaj kontrate.

6.8 Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar nga “Intesa Sanpaolo Bank”, vërtetohet se personi i lidhur, z. B.K., ka kryer pagesën për shoqërinë sipërmarrëse “\*\*\*” sh.p.k., me anë të një transferte bankare në datën 5.1.2010, për të gjithë shumën. Më tej, personi i lidhur, z. B.K. ka firmosur kontratën e shitjes me nr. \*\*, datë 30.11.2011, për këtë apartament, duke e regjistruar edhe në ZVRPP-në Tiranë, në datën 14.12.2011.

6.9 Fakti i mësipërm është konfirmuar edhe nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., e cila në përgjigje të kërkesës së Komisionit i ka bashkëngjitur të njëjtin mandatdepozitimi bankar shkresës së saj<sup>21</sup>.

---

<sup>18</sup> Kontratë shitblerje pasuri e paluajtshme apartament nr. \*\*, datë 30.11.2011, + praktika kontratës, certifikatë pronësie nr. \*\*, datë 14.12.2011 + kartel pasurie; kontratë porosisë datë 5.1.2010, midis z. B.K. dhe shoqërisë “\*\*\*”; nxjerrje llogarie nga “ISP Bank”, ku vërtetohet se z. B.K. ka kryer pagesën për blerjen e apartamentit në vlerën 38.260 euro, në datën 5.1.2010, me përfitues shoqërinë “\*\*\*”.

<sup>19</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 4.4.2019.

<sup>20</sup> Kontratë shitblerje pasuri e paluajtshme apartament nr. \*\*, datë 30.11.2011, i apartamentit me sip. 78.33 m<sup>2</sup>, ndodhur në Yzberisht, Tiranë, në vlerën 5,270,000 lekë, me blerës B.K. e parapaguar prej tij në datën 5.1.2010 kur është lidhur kontrata e porosisë + praktika kontratës; certifikatë pronësie nr. \*\*, datë 14.12.2011 + kartel pasurie, për apartamentin me sip. 78.33 m<sup>2</sup> në emër të z. B.K.; kontratë porosisë datë 5.1.2010, midis B.K. dhe shoqërisë “\*\*\*”, për apartament me sip. 91.1 m<sup>2</sup>, Yzberisht, Tiranë, në vlerën 38.260 euro, vlerë të cilën blerësi e ka paguar me lidhjen e kontratës në llogarinë e sipërmarrësit; nxjerrje llogarie “Intesa Sanpaolo Bank”, ku vërtetohet se B.K. ka kryer pagesën për blerjen e apartamentit në vlerën 38.260 euro, në datën 5.1.2010, me përfitues shoqërinë “\*\*\*”.

<sup>21</sup> Shkresë e shoqërisë “\*\*\*”, datë 5.6.2019.

6.10 ZVRPP-ja Tiranë konfirmon se z. B.K. ka të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, pasurinë me sip. 78.33 m<sup>2</sup>, nr. \*\*\*, z.k. \*\*\*, dhe me përshkrimin se ai është pronar i kësaj pasuri.

6.11 Nga hetimi i dokumentacionit të sipërpërmendur u konstatua se personi i lidhur, z. B.K., nuk kishte deklaruar saktë vlerën e blerjes së këtij apartamenti, pasi në kontratën e porosisë dhe të shitjes vlera ishte 38.260 euro, ndërkohë që në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, personi i lidhur deklaroi se e ka blerë për vlerën 32.260 euro.

6.12 Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me këtë mospërputhje, ka deklaruar se pasqyrimi në disa deklarata në shumën e 32.260 eurove është gabim material në të shkruar, ardhur nga pakujdesia, si dhe nga plotësimi i deklaratave elektronikisht, akt mbi akt. Rezulton qartë se është një gabim i provuar si i tillë, si nga deklarimi periodik i vitit 2010, ashtu edhe nga mandati bankar, apo edhe nga kontrata përkatëse dorëzuar në ILDKPKI, që shuma prej 38.260 euro është shuma e blerjes së apartamentit.

6.13 Si përfundim, nga hetimit dhe shqyrtimi i dokumentacioni rezultoi se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit ka paraqitur në mënyrë të pasaktë vlerën e blerjes së këtij apartamenti.

6.14 Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm, se kjo pasaktësi në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, nuk ka pasur për qëllim fshehjen e shumën së blerjes, por ka qenë një harresë. Kjo vërtetohet dhe me anë të dokumentacionin justifikues të dërguar nga vetë personi i lidhur në deklarin e tij, dhe vlerësimi i të gjithë deklarin në tërësi. Kjo pasaktësi në deklarim nuk krijon dyshime se subjekti i rivlerësimit ka pasur për qëllim fshehjen e çmimit të blerjes, pasi ai ishte përcaktuar saktësisht në kontratën e shitblerjes dhe të porosisë së këtij apartamenti.

6.15 **Në lidhje me burimet e krijimit** të këtij apartamenti nga personi i lidhur/z. B.K., nga hetimi i Komisionit u vërtetua me dokumentacion ligjor se si burim krijimi ka shërbyer një hua e marrë nga z. B.K. në shumën 12.000 euro, një tjetër hua marrë nga znj. E.D. në shumën 12.000 euro, si dhe kursimet nga paga e personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, si më poshtë vijon:

(i) Hua e marrë nga z. B.K. (i cili është babai i personit të lidhur), në shumën 12.000 euro (ekuivalenti në datë 5.1.2010 është shuma 1.653.600 lekë). Burimi i krijimit të shumës së dhënë hua janë kursime të familjes.

6.16 Për të vërtetuar burimin e krijimit, personi i lidhur i ka bashkangjitur deklaratës “Vetting”, kontratë huaje pasurie e luajtshme të holla me nr. \*\*\*, datë 6.1.2010, midis huamarrësit B.K. dhe huadhënësit B.K., për shumën prej 12.000 euro, të marrë në datën 4.1.2010, me afat deri në datën 4.1.2022, pa kamatë dhe pa interesa.

6.17 Duke qenë se në deklaratën “Vetting” ishte depozituar vetëm dokumenti i cili vërtetonte burimin, por jo legjitimitetin e të ardhurave, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të dërgonte dokumentacion ligjor mbi legjitimitetin dhe mjaftueshmërinë e burimit të krijimit të huadhënësit.

6.18 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjen e datës 11.6.2019, dërgoi dokumentacion justifikues ligjor<sup>22</sup> në lidhje me të ardhurat e z. B.K. dhe familjarëve të tij, për të vërtetuar mundësitë financiare që kishte z. B.K. për të dhënë huan prej 12.000 euro personit të lidhur/z. B.K.

6.19 Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni rezultoi se në datën 4.1.2010, shtetasi B.K. ka pasur pasuri në formën e likuidimeve dhe investimeve në bono thesari në shumën 5.785.922 lekë. Të ardhurat e akumuluar për periudhën 1994 – 2009, për shtetasit B.K., Z.D. dhe E.K., kanë qenë 6.726.044 lekë, ndërkohë që gjendja e likuiditeteve në bankë dhe investimet në bono thesari deri në datën 4.1.2010 kanë qenë në total në shumën 5.785.922 lekë.

6.20 QKB-ja, në përgjigje të kërkesës së Komisionit,<sup>23</sup> konfirmon se shtetasit e mësipërm nuk figurojnë të regjistruar në regjistrin tregtar.

6.21 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, në përgjigje të kërkesës së Komisionit,<sup>24</sup> konfirmon se këta shtetas nuk kanë aktivitete privat të regjistruar në emër të tyre.

(ii) Hua e marrë nga personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, znj. E.D., në shumën 12.000 euro (ekuivalenti në datën 5.1.2010 është shuma 1.653.600 lekë).

6.22 Për të vërtetuar burimin e krijimit, personi i lidhur/z. B.K. i ka bashkëngjitur deklaratën “Vetting”, deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 5.1.2010, ku rezulton se z. B.K. deklaron se ka marrë hua në vlerën 12.000 euro, në datën 4.1.2010, shtetases E.D., pagesë e kryer jashtë zyrës noteriale. Gjithashtu, ka bashkëngjitur edhe dokumentacion në gjuhën angleze në lidhje me punësimin e shtetases E.D.

6.23 Duke qenë se në deklaratën “Vetting” ishte depozituar dokumentacion i cili vërtetonte burimin, shumën por jo legjitimitetin e të ardhurave, nëse ishin paguar taksa apo jo, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të dërgonte dokumentacion ligjor mbi legjitimitetin e burimit të krijimit të huadhënësës.

6.24 Subjekti i rivlerësimit dërgoi dokumentacion ligjor justifikues<sup>25</sup>, nga ku rezultoi se shtetasja E.D. (si huadhënëse), ka qenë e punësuar pranë “\*\*\*\*” dhe ka pasur kontrata shërbimi

---

22 B.K.: kartela personale e oficerit nr. \*\*\*, lëshuar nga Qendra e Personel Rekrutimit me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 5.6.2019, vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\* prot., datë 5.6.2019, vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 26.2.2019, i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shkodër; vërtetim, datë 7.6.2019, i Qendrës së Personel Rekrutimit për trajtim me pagesë kalimtare të ushtarakut në rezervë; Z.D.: vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore nr. \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\* prot., datë 5.6.2019, lëshuar nga Dega e Arkivës së Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shkodër; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 20.2.2013, e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Shkodër; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 26.2.2019, i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shkodër për trajtim pleqërie; E.K.: vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 17.10.2016, i Ministrisë së Drejtësisë.

<sup>23</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 12.6.2019.

<sup>24</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 13.6.2019.

<sup>25</sup> Vërtetim datë 5.6.2019, lëshuar në organizata jofitimprurëse “\*\*\*\*” për shtetasen E.D., kopje të librezës së punës në emër të saj, si dhe *statementin* bankar për periudhën 2008; kontratë pune datë 30.12.2009 me \*\*\*, *statement* bankar; si dhe vërtetim të lëshuar nga Drejtoria e Kontributeve Shoqërore të ISSH-së datë 5.6.2019.



me \*\*\* Shqipëri. Më tej, u vërtetua se të ardhurat e realizuara në total janë në vlerën 3.021.859 lekë.

(iii) Kursime nga paga të personit të lidhur/z. B.K.

6.25 Komisioni hetoi dhe mbi burimin e tretë të krijimit, kursimet nga paga e personit të lidhur/z. B.K. Personi i lidhur/z. B.K. nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” dhe në deklaratën e interesave private se cilës periudhë i përkasin kursimet që kishte përdorur për blerjen e këtij apartamenti. Përgjatë periudhës 1.1.2010 – 5.1.2010, në llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit nuk ka pasur asnjë lëvizje.

6.26 Duke u mbështetur në deklaratimet e gjendjes *cash* në deklaratat vjetore të interesave private, të ardhurat, detyrimet dhe në të gjithë dokumentacionin e administruar gjatë hetimit, Komisioni kreu analizën financiare në datën e kryerjes së pagesës për këtë pasuri, e paraqitur në tabelën e mëposhtme:

	<b>Përshkrimi</b>	<b>05.01.2010</b>
<b>1</b>	<b>PASURI</b>	<b>5,270,000</b>
	Apartament banimi me sip. 78.33 m <sup>2</sup>	5,270,000
<b>2</b>	<b>DETYRIME</b>	<b>3,307,200</b>
	Shumë e marrë hua nga B.K.	1,653,600
	Shumë e marrë hua nga E.D.	1,653,600
<b>3</b>	<b>LIKUIDITETE NË FILLIM TË PERIUDHËS (1.1.2010)</b>	<b>348,814</b>
	Gjendja e llogarive bankare	348,814
	Gjendje <i>cash</i>	0
<b>4</b>	<b>LIKUIDITETE NË FUND TË PERIUDHËS (5.1.2010)</b>	<b>348,814</b>
	Gjendja e llogarive bankare	348,814
	Gjendje <i>cash</i>	0
	<b>DIFERENCA (TË ARDHURA -PASURI-SHPENZIME 2-1+3-4)</b>	<b>-1,962,800</b>

6.27 Në lidhje me shlyerjen e detyrimit ndaj shtetases E.D., Komisioni kreu analizën financiare për pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit për periudhën përpara martese, në shumën 4.000 euro gjatë vitit 2010 dhe në shumën 3.000 euro përgjatë vitit 2011, si dhe për periudhën pas martese në shumën 3.000 euro gjatë vitit 2012 (subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti nuk kanë përcaktuar datën e shlyerjes), dhe në shumën 2,000 euro përgjatë vitit 2013.

6.28 **Nga analiza financiare rezultoi se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për shlyer huan ndaj shtetases E.D. në shumën 7.000 euro përgjatë viteve 2010 – 2011, si dhe subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti, kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për shlyer huan ndaj shtetases E.D. në shumën 5.000 euro përgjatë viteve 2012 – 2013.**

6.29 Komisioni, bazuar në faktet e sipërcituara për hetimin ndaj personit të lidhur z. B.K., përfundoi hetimin administrative kryesisht dhe i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit për çfarë konstatoi më lart.

6.30 Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij pas kalimit të barrës së provës, në lidhje me këtë apartament deklaroi se detyrimet financiare të personit të lidhur/bashkëshortit për këtë pasuri veçmas janë dokumentuar me deklarata noteriale përkatëse të cilat përkojnë me datat 5.1.2010 dhe 6.1.2010. Në lidhje me këto marrëdhënie financiare subjekti nuk ka asnjë shfaqje të vullnetit të tij, duke mos pasur asnjë lidhje me pasurinë apo detyrimet. Për pasojë, shprehet subjekti, nuk mund të më kërkohet llogaridhënie për veprime të kryera para nisjes së bashkëjetesës e cila përkon me lidhjen e martesës në datën 30.11.2012.

6.31 Më tej, subjekti deklaroi se kjo pasuri, apartament banimi, është deklaruar gjithmonë si pasuri e ndarë në deklaratat e pasurisë. Kjo pasuri edhe sipas përcaktimeve që bën Kodi i Familjes për pasurinë bashkëshortore, nuk konsiderohet pasuri bashkëshortore. Konkretisht, neni 74 i Kodit të Familjes përcakton përbërjen e bashkësisë gjatë martesës ku thuhet: *“Bashkësia përbëhet nga: a) pasuria e fituar nga të dy bashkëshortët, së bashku ose veç e veç, gjatë martesës; b) të ardhurat nga veprimtaria e veçantë e çdo bashkëshorti gjatë martesës, nëse nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkëpronësisë; c) frytet e pasurisë së çdo bashkëshorti, që janë marrë dhe nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkëpronësisë; ç) veprimtaria tregtare e krijuar gjatë martesës”*. Kjo pasuri është blerë në datën 5.1.2010, duke deklaruar si burim krijimi kursimet nga paga e bashkëshortit ndër vite, si dhe detyrimet financiarë të tij ndaj të tretëve. Pra, bashkëshorti në deklaratimet e tij periodike të pasurisë ka deklaruar burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie nga kursimet, nga paga, dhe nga huat.

6.32 Subjekti deklaroi: *“Fakti i fillimit të bashkëjetesës me njëri-tjetrin, që sikurse thashë përkon me datën e martesës, provohet nga certifikata e martesës e cila përcakton gjendje juridike (de iure). Gjithashtu, de facto, provohet që në kohën e blerjes së kësaj pasurie, unë punoja në jug në Prokurorinë e Rrethit Lushnjë, ndërsa bashkëshorti në veri në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë. Edhe pasi bashkëshorti është transferuar me punë në Shkodër dhe unë në Tiranë, kemi vazhduar secili jetesën në banesat respektive të prindërve tanë, Tiranë dhe Shkodër, ku edhe adresat e banimit i kemi pasqyruar në deklaratat tona periodike të pasurisë për çdo vit. Po ashtu, kam sqaruar se në banesë nuk është bërë asnjë investim apo punim shtesë. Jemi përpjekur të mobilim banesën me mundësitë që kishim ne vetë, mobilim i cili ka vazhduar i shtrirë në vite. Lidhur me këtë fakt kam paraqitur çdo dokument që disponoj në lidhje me pajisjet elektroshtëpiake e të tjera, të cilat përcaktojnë dukshëm datën se kur ato janë blerë dhe adresën/ destinacionin e tyre, që është banesa në Yzberisht. Sqaroj se ky mobilim ka qenë i nevojshëm në mënyrë që ne të fillonim bashkëjetesën me njëri-tjetrin. Bashkëjetesa pas kësaj date rezulton dukshëm edhe nga faturat e OSHEE-së dhe UKT-së, po të krahasosh sasinë e energjisë apo të ujit të harxhuar para dhe pas muajit nëntor 2012”*.

6.33 Për sa i përket huas së dhënë nga shtetasja E.D. është paraqitur dokumentacioni i justifikuar ligjor, vërtetim nga punëdhënësi për përdhën 2005 – 2008, dhe kontratat e punës me punëdhënësin \*\*\*, si dhe *statementet* bankare që provojnë derdhjen e këtyre të ardhurave, ku si burim i krijimit të tyre është pikërisht kontrata e punës, e cila njihet sipas ligjit si burim krijimi pasurie.

6.34 Për sa i përket pasurive të prindërve dhe vëllait të bashkëshortit, subjekti sqaroi se nuk ka pasur asnjë dijeni për pasuritë e tyre, nuk ka pasur asnjë lidhje pasurore, përfitim pasuror prej tyre, apo të ketë banuar me ta. Ajo sqaroi se nga tërësia e veprimtarisë bankare rezulton dukshëm që babai i bashkëshortit të subjektit ka ndjekur kurset e këmbimit dhe interesat bankare, duke investuar kursimet familjare në tregun bankar. Babai i bashkëshortit të subjektit ka hapur dhe ka mbyllur vazhdimisht depozita, duke i kaluar paratë në lekë, duke i këmbyer në valuta të tjera dhe duke i investuar përsëri në tregun bankar. Nga të dhënat e analizuara, vetëm deri në vitin 2010, ka përfituar interesa bankare në shumën prej afro një milion lekë, para të cilat i ka investuar përsëri në tregun bankar. Po nga dokumentacioni bankar rezulton se pothuajse të gjitha depozitat bankare janë transferuar në kohë, në një bankë të nivelit të dytë “First Investment Bank”, dhe në fillim të vitit 2015, pasi janë këmbyer në euro pjesa më e madhe e kursimeve i janë transferuar shoqërisë ku ka blerë apartamentin në një zonë rurale në Kashar.

6.35 Bashkëshorti i subjektit ka marrë paga nga muaji tetor i vitit 2006, kur është emëruar gjyqtar deri në fund të vitit 2009, shumën e parave prej afro 3.2 milion lekë. Sipas *statementit* bankar të llogarisë në “Raiffeisen Bank” rezulton se të ardhurat e tij i ka pasur në një llogari rrjedhëse të çelur që në kohën e Shkollës së Magjistraturës, ku gjendja në fillimin e punës ka qenë 265.558, lekë. Më pas, po në këtë llogari është hedhur paga nga puna si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrësi ashtu edhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë. Po nga kjo llogari janë kaluar të ardhurat në hapjen e depozitave bankare me afat, po në “Raiffeisen Bank” të cilat janë të përfshira në një *statement* bankar, ku pasqyrohen të gjitha veprimet e kryera prej tij.

6.36 Nga këto të dhëna të cilat konstatohen se bashkëshorti i saj për periudhën 2006 – 2009 ka pasur të ardhura afro 3.585.413 milionë lekë. Nga këto ka të provuar se ka tërhequr nga llogaria bankare në “Raiffeisen Bank” vlera të konsiderueshme, çka provon se ka kursyer të paktën shumën prej 2.5 milionë lekë të gjitha të kanalizuar në sistemin bankar, llogari rrjedhëse dhe depozita me afat.

6.37 Në përfundim, subjekti sqaroi se bashkëshorti i saj, ndryshe nga sa konstatohet në relacionin edhe pas zbritjes së shpenzimeve për konsum, duke pasur parasysh që në vitet 2007 – 2008, ka jetuar në Tropojë, ku niveli jetik në këtë qytet ka qenë i ulët, ka pasur të ardhura të ligjshme për të justifikuar blerjen e apartamentit, dhe si të tilla ato duhet të konsiderohen nga Komisioni. Subjekti këtë e ka provuar përmes vërtetimeve, të ardhurave, si dhe *statementeve* bankare ku pasqyrohen të gjitha lëvizjet ndër vite, si dhe vlerat e kursyera.<sup>26</sup>

---

<sup>26</sup> Kopje e *email-it* të dërguar nga përfaqësues i Ambasadsadës Amerikanë në përgjigje të kërkesës së bërë nga shtetasi B.K. në lidhje me trajnimin e bërë në vitin 2011 në Amerikë; certifikatë martesore printuar nga portali e-Albania; kopje e printimit të *statementit* bankar të “Tirana Bank” për vitet 2012 – 2013 në emër të shtetasit B.K.; printim i tre faqeve të para të formularit të deklaratës vjetore të interesave privat periodik/vjetor deri në vitin 2012 dhe atë pas vitit 2012; printim i të dhënave nga sistemi tatimor në lidhje me regjistrimin në organin tatimor të subjektit \*\*\*, tabelë analizim interesi bankar për depozitat deri 4.1.2010 të shtetasit B. K.; mandatërheqeje nga depozitat në banka datë 28.10.2009 dhe datë 28.12.2009 nga shtetasi B.K.; kopje kontrate për privatizim banese së bashku me akt shitblerje datë 24.08.1993 të shtetasve B.K. e Z.D.; kopje e vendimit të Ministrisë së Mbrojtjes datë 15.9.1999 për shpërndarjen e objekteve për strehim sipas listës në emër të shtetasit B.K.; kopje kontrate sipërmarrje punimesh ndërtimi lidhur në datën 20.1.2008 mes shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k.

**6.38 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me burimin e krijimit të këtij apartamenti, arrin në përfundimin se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, z. B.K., nuk ka pasur mjaftueshëm burime të ligjshme financiare për të blerë këtë apartament.**

6.39 Pavarësisht këtij përfundimi, Komisioni vlerëson se mungesa e burimeve të ligjshme për personin e lidhur, z. B.K., nuk mund të konsiderohet si deklaram i pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë nga subjekti i rivlerësimit, pasi kjo e fundit provoi me dokumentacion ligjor provues se martesë ligjore e subjektit me personin e lidhur ka ndodhur në datën 30.11.2012, ndërkohë që likuidimi i të gjithë pagesës për blerjen e këtij apartamenti në shumën prej 38.260 euro ka ndodhur brenda datës 5.1.2010, sipas dokumentacionit justifikues.

6.40 Subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm dhe provoi se nuk ka pasur asnjë lidhje interesi midis subjektit dhe personit të lidhur/z. B.K. në momentin e blerjes së këtij apartamenti.

**6.29 Në përfundim,** nga të gjitha faktet e prezantuara më sipër, trupi gjykues, vlerëson se subjekti i rivlerësimit arriti të shpjegojë dhe të provojë me provat që nje legjislacioni procedural situatën faktike, si dhe të japë një shpjegim për rrethanat e pretenduara prej tij në aspektin logjik për: (i) kohën e porositjes dhe shitblerjes së apartamentit; (ii) momentin e likuidimit të të gjithë shumës së këtij apartamenti; (iii) mënyrën pagesës; (iv) kohën e marrjes së huave; dhe (v) kohën se kur është lidhur martesë midis subjektit dhe z. B.K.

Nga provat e administruara në hetim nuk rezultoi asnjë fakt i dalë që të vërë në dyshim vërtetësinë e këtyre rrethanave, por rezultuan prova të tjera që mbështesnin këtë qëndrim të subjektit të rivlerësimit.

**Në konkluzion të sa më sipër,** në referencë të parashikimeve ligjore të nenit 51, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues, vlerëson se bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi dhe në bindjen e brendshme, në zbatim të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, deklarimi i pasurive të subjektit të rivlerësimit, është në përputhje me detyrimet ligjore që subjekti i rivlerësimit ka pasur për të bërë në zbatim të legjislacionit. Rrethana e analizuar më sipër nuk përbën arsye për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

## **7. Llogari rrjedhëse në “Bankës Kombëtare Tregtare” në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.**

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit, administroi:

7.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur<sup>27</sup>.

---

<sup>27</sup> Të ardhura nga puna pranë Qendrës Shqiptare të Drejtave të Njeriut, pozicioni, asistent-koordinator, në periudhën korrik – shtator 2004; të ardhura nga puna si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, periudha tetor 2006 – nëntor 2007; të ardhura nga puna si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, periudha nëntor 2007 – mars 2010; të ardhura nga puna si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, periudha prill 2010 – tetor 2013. të ardhura nga puna si gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, periudha nëntor 2013 e në vazhdim; të ardhura nga puna si pedagog pranë Universiteti "Gjon Buzuku" Shkodër (shoqëria “\*\*\*” sh.p.k.)

7.2 Provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja dhe Komisioni.

7.3 Dokumentacioni i administruar nga “BKT”-ja.<sup>28</sup>

b. Arsytimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm.

7.4 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi se bashkëshorti i saj disponon gjendje në llogarinë rrjedhëse me nr. \*\*\* në “BKT”, si dhe kartë krediti me gjendje debite 0 lekë, me limit 85.000 lekë. Vlera: 1.136.101 lekë. Pjesa takuese: 100%.

7.5 Si burim krijimi, subjekti deklaroi se kanë shërbyer kursimet nga paga, të akumuluar ndër vite.

7.6 Nga hetimi i Komisionit, “BKT”-ja konfirmon se z. B.K. disponon llogari rrjedhëse me gjendje në shumën 1.136.101 lekë, në datën 26.1.2017. Gjendja e kësaj llogarie është akumuluar duke filluar nga viti 2013 e në vazhdim.

7.7 Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni rezultoi se bashkëshorti i subjekti të rivlerësimit ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar këtë gjendje llogarie bankare.

7.8 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit, arrin në përfundimin se subjekti ka bërë deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka burime financiare me dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e deklaruara.

## **8. Kontrolli i deklarimeve vjetore të interesave në ILDKPKI**

8.1 Në deklaratën “Vetting” vlera e apartamentit me sip. 78.33 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z.k. \*\*\*, Yzberisht, komuna Kashar, Qarku Tiranë, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është 32.260 euro. Bashkëshorti i subjektit, që gjithashtu mbart të drejtën e deklaramit në ILDKPKI, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, vlerën e këtij apartamenti e ka deklaruar 38.260 euro. Ndërkohë, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011, vlerën e këtij apartamenti e ka deklaruar 32.260 euro.

8.2 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shtesë/pakësim/gjendje të llogarisë rrjedhëse nr. \*\*\* në “Raiffeisen Bank” në deklaratat e interesave private, përgjatë periudhës 2006 – 2013.

8.3 Subjektit iu kërkua të japë shpjegime për sa rezultoi gjatë hetimit, e cila deklaroi se lidhur me pikën e parë, pasqyrimi në disa deklarata në shumën 32.260 euro është gabim material në të shkruar, ardhur nga pakujdesia, si dhe nga plotësimi i deklaratave elektronikisht, akt mbi akt. Rezulton qartë se është një gabim, si nga deklarimi periodik i vitit 2010, ashtu edhe nga mandati bankar, apo edhe nga kontrata përkatëse dorëzuar në ILDKPKI në shumën e blerjes së apartamentit prej 38.260 euro. Referuar pikës së dytë, mospasqyrimi i gjendjes së llogarisë rrjedhëse deri në vitin 2013 në deklarata vjetore periodike ka ardhur për shkak të mospasjes së përvojës në plotësimin e deklaratës, por edhe të vlerave të vogla monetare.

**8.4 Në përfundim, Komisioni çmon se mospasqyrimi i këtyre të ardhurave nga subjekti dhe personi i lidhur/bashkëshorti, në deklaratat periodike vjetore, sipas konstatimeve më sipër, për sa kohë që provohet burimi i ligjshëm i tyre, e përjashton rrezikun e gjendjes në situatën e**

---

<sup>28</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 1.4.2019.

parashikuar nga germat “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” .

### **Konkluzioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë**

Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, barazisë së palëve, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, arrin në përfundimin se nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit, subjekti ka kryer deklarim të saktë dhe në përputhje me ligjin, ka pasur burime financiare të ligjshme e të mjaftueshme për krijimin e pasurisë, nuk ka kryer deklarim të rremë apo fshehje të pasurisë. Subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

## **VI. PROCESI I RIVLERËSIMIT TË KONTROLLIT TË FIGURËS**

1. **Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)** ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. DSIK-ja ka dërguar raportin nr. \*\*\* prot., datë 4.4.2019, deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së, nr. \*\*\*, datë 2.4.2019, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016.
2. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.
3. **Si konkluzion**, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Elida Kaçkini.
4. Pavarësisht nga raporti i dërguar nga DSIK-ja, Komisioni ka kryer hetim administrativ, prej të cilit rezulton se konstatimet e Grupit të Punës për kontrollin e figurës janë të sakta.
5. Më tej, Komisioni konstatoi se nuk ka asnjë informacion apo indice që të implikojë subjektin në kryerjen e ndonjë vepre penale apo cenim të figurës, nuk ka denoncime apo të dhëna të tjera që të rezultojë se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.
6. **Në përfundim, Komisioni çmon se** subjekti i rivlerësimit e ka dorëzuar deklaratën për figurën në kohën e përcaktuar nga ligji nr. 84/2016, nuk ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe nuk ka bërë deklarim të pamjaftueshëm në lidhje me kontrollin e figurës, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës. Subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

## VII. PROCESI I RIVLERËSIMIT PËR AFTËSITË PROFESIONALE

Këshilli i Lartë Prokurorisë, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ka dorëzuar raportin profesional për subjektin e rivlerësimit.

Nga vlerësimi i tri dokumenteve të përzgjedhura nga subjekti dhe pesë dosjeve të përzgjedhura me short, lidhur me kriteret e vlerësimit, sipas ligjit nr. 96/2016, janë vënë re këto gjetje:

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Elida Kaçkini, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në çdo rast. Konstatohet se subjekti bën analizë mbi rrethanat e faktit dhe provat e mbledhura, duke shprehur qëndrimin e saj logjik mbi zgjidhjen ligjore.

2. Në vlerësimin e punës së subjektit të rivlerësimit, prokurores Elida Kaçkini, për vitet 2014, 2015, 2016 të bërë nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se për aftësitë profesionale, në cilësinë e prokurorit, është vlerësuar “shumë mirë”.

3. Nga gjetjet në dokumentet ligjore të analizuara, rezulton se nga subjekti i rivlerësimit tregohet vëmendje në kryerjen e veprimeve hetimore në dinamikë dhe në respektim të afateve ligjore të kërkuara, duke i dhënë një zgjidhje të shpejtë çështjeve të trajtuara. Ka treguar aftësi të mira në organizimin efektiv të kohës së punës, e lidhur kjo me kohën e përfundimit të çështjeve të analizuara dhe me numrin total të çështjeve të përfunduara, për të gjithë periudhën e vlerësimit.

4. Subjekti i rivlerësimit, znj. Elida Kaçkini, kryen veprime procedurale hetimore të cilat rezultojnë të jenë produktive. Konstatohet që nga subjekti i rivlerësimit veprimet dhe procedurat në kuadër të procedimeve penale dhe materialeve kallëzuese, u referohen dispozitave ligjore përkatëse, duke mbledhur provat dhe aktet e nevojshme dhe duke konkluduar në një vendimmarrje. Lidhur me njoftimet e vendimmarrjeve konstatohet se është respektuar detyrimi për të kryer njoftimet përkatëse të subjekteve.

5. Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira në drejtim të përfundimit të hetimeve, rregullsisë së akteve dhe mbajtjes së tyre sipas një rregulli të mirëpërcaktuar në dosjet përkatëse. Dosjet e vëzhguara janë të rregullta, të plota dhe aktet procedurale të përpiluara janë të strukturuar dhe në respektim të normave të drejtshkrimit.

6. Rezulton se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit, si dhe nuk janë paraqitur të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Nga dokumentet ligjore të analizuara, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Në asnjë prej dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar.

7. Në lidhje me vlerësimin e gatishmërisë për t’u angazhuar, subjekti i rivlerësimit ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh me temë në fushën penale, të organizuar pranë dhe jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, në Shqipëri dhe jashtë saj.

## **Konkluzione për rivlerësimin e aftësive profesionale**

Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv dhe konsiderohet “i aftë”. Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

## **Denoncimet nga publiku**

Për subjektin e rivlerësimit, znj. Elida Kaçkini, në Komision janë administruar gjashtë denoncime nga publiku, si më poshtë vijon:

1. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 15.3.2018, i shtetases Xh. J., e cila denoncon subjektin e rivlerësimit për mosfillimin e hetimit.
2. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 20.3.2018, i shtetases M. T., e cila pretendon se janë një sërë provash dhe rrethanash të cilat nuk janë marrë parasysh nga subjekti i rivlerësimit dhe gjyqtarët.
3. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 4.5.2018, i shtetasit R. Ç., i cili ka paraqitur ankesë ndaj subjektit të rivlerësimit si rezultat i shtrembërimit të fakteve të bëra prej saj, si dhe mosfillimin e procedimeve penale.
4. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 12.9.2018, i shtetasit B. F., i cili denoncon subjektin e rivlerësimit se ka manipuluar procesin duke shmangur ekspertizën e bërë nga Drejtoria e Policisë Shkencore.
5. Denoncimet nr. \*\*\* prot., datë 26.02.2019 dhe nr. \*\*\* prot., datë 7.3.2019, të shtetasit K. Z., i cili, ndër të tjera, ankohet edhe për subjektin e rivlerësimit, prokuroren e çështjes Elida Kaçkini, duke e akuzuar për njëanshmëri dhe korrupsion.

Pasi mori në shqyrtim ankesat e depozituara nga publiku, lidhur me denoncimet e administruara, si dhe të gjithë aktet e tjera ligjore, Komisioni konstaton se nuk ka indice dhe prova që të provohen faktet e pretenduara.

**Për sa më sipër, Komisioni**, pasi kreu hetim të hollësishëm mbi këto denoncime, dhe pasi u shqyrtuan në mbështetje të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arriti në përfundimin se nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

## **VIII. KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Elida Kaçkini, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:



- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot, dhe referuar germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Elida Kaçkini.
  2. Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
  3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
  4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
- Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 18.7.2019.

## **KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Valbona SANXHAKTARI**

**Kryesuese**

*(Mendim paralel)*

**Xhensila PINE**  
**Anëtare**

**Etleda ÇIFTJA**  
**Relatore**

*Sekretare gjyqësore*  
*Olsida Goxhaj*

